

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR SHËRBIMIN E JASHTËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është rregullimi i veprimtarisë së Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë. Përgatitja e projekt-ligji “Për shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë” erdhi si një domosdoshmëri për rregullimin e disa problematikave të hasura nga aplikimi i ligjit aktual për shërbimin e jashtëm, rregullimi i të cilave do i shërbejë një shërbim të jashtëm modern, i cili duhet ti përgjigjur detyrave të ngarkuara nga Kushtetuta dhe nga programet e qeverive.

Periudha gati dhjetë vjeçare që ka kaluar nga ligji, i cili aktualisht është në fuqi ka bërë të nevojshëm rishikimin edhe të këtij akti me synim për t’ia përshtatur interesave të kohës. Projektligji ndër të tjera, reflekton krijimin e mundësisë për futjen në Shërbimin e Jashtëm të ekspertëve të fushës, duke respektuar detyrimet që kërkohen nga ligji nr.152/2013, datë30.5.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, por duke u njohur për efekt të llogaritjes së gradës diplomatike personale vitet e punës në Shërbimin e Jashtëm

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji për shërbimin e jashtëm është në përputhje të plotë me programin e Këshillit të Ministrave dhe një instrument shumë i rëndësishëm i zbatimit të programimit të politikës së jashtme të shtetit shqiptar. Përgatitja e këtij projektligji ka qenë një ndër angazhimet kryesore të Ministrisë së Punëve të Jashtme në zbatim të detyrave në fushën e politikës së jashtme që bëjnë pjesë në programin qeveritar dhe është pjesë e Planit Analitik të miratuar për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2024.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji për shërbimin e jashtëm, në ndryshim nga ligji aktual sjell disa risi dhe efekte pozitive që synojnë konsolidimin e mëtejshëm të këtij shërbimi mbështetur në karrierën diplomatike. Më konkretisht këto elementë përmbledhen si vijon:

- Projektligji rregullon me mirë fushën e kompetencave të Shërbimit të Jashtëm dhe raportet me institucionet kushtetuese, qendrore dhe vendore në fushën e marrëdhënieve me jashtë;
- Zgjeron hapësirat e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstytucional në fushën e marrëdhënieve me jashtë, në përputhje me dinamikën e zhvillimeve në marrëdhëniet ndërkombëtare;
- Rregullon në mënyrë më të qartë procesin e emërimit dhe mbarimit të mandatit të kreut të misionit diplomatik dhe postit konsullor si dhe personelit diplomatik e konsullor;
- Forcon kriteret profesionale për rekrutimin e diplomatëve të karrierës mbështetur në nivelet e tyre akademike;
- Mundësohet përlllogaritja për efekt të marrjes së gradës diplomatike personale të diplomatëve të karrierës të cilët në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë emëruar në misionet diplomatike dhe konsullore jashtë sistemit të karrierës diplomatike apo punojnë në organizatat ndërkombëtare;
- Sigurohet pastërtia dhe siguria e figurës së personelit të shërbimit të jashtëm;
- Për herë të parë futet si koncept ligjor krijimi i strukturës së Akademisë Diplomatike, e cila do të jetë jo vetëm në shërbim të përmirësimit profesional të diplomatëve, por edhe si një strukturë që në bashkëpunim me struktura të ngjashme homologe, do të ofrojë kurse trajnimi në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare;
- Përcaktohet në mënyrë më të qartë përfshirja në misionet diplomatike dhe postet konsullore të personave jashtë karrierës diplomatike, si dhe dhënia e mundësisë që në përputhje me kriteret për pranimin në shërbimin civil të bëhen pjesë e shërbimit të jashtëm;

- Në funksion të krijimit të një hierarkie më racionale në strukturën e gradave diplomatike, janë forcuar kriteret për marrjen e tyre;
- Mirëpërcaktohen kriteret për trajtimin financiar të diplomatëve jashtë vendit, kjo për të krijuar një mjedis dinjitoz për punonjësit, të cilët ashtu si shërbimi ushtarak i detyrueshëm, kanë detyrë funksionale transferimin jashtë vendit, kurdo dhe kudo që ka nevojë institucioni.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën, Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore, Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”. Njëkohësisht në hartimin e tij janë marrë për bazë legjislacionet analoge të disa vendeve të Bashkimit Evropian dhe të rajonit.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon të përafrojë ndonjë akt të *acquis*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga nëntë krerë dhe 65 dispozita, si vijon:

Në Kreun I janë trajtuar dispozita të përgjithshme për çështje si “Qëllimi”, “Objekti”, “Përkufizime”, “Parimet”, “Baza ligjore”, “Funksionet e shërbimit të jashtë”.

Në Kreun II është rregulluar marrëdhëniet e shërbimit të jashtëm me institucionet kushtetuese, qendrore dhe vendore, si bashkëpunimi me Presidentin e Republikës, Kuvendin, Kryeministrin, si dhe me ministritë, institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore. Rregullohen kompetencat dhe detyrimet e tyre në këtë fushë si dhe bashkërendimi i veprimtarisë së tyre me Shërbimin e Jashtëm.

Në Kreun III rregullohet procesi i njohjes së shtetit dhe qeverisë, si dhe vendosja dhe ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike.

Në Kreun IV është trajtuar organizimi dhe funksionet e Shërbimit të Jashtëm, e cila përbëhet nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, misionet diplomatike dhe postet konsullore. Rregullohet përbërja e strukturave të MEPJ-së dhe funksionet e tyre. Shtohet Akademia Diplomatike si qendër e formimit profesional, e studimit dhe mendimit diplomatik shqiptar. Shtohet Komisioni i Apelimit, për shqyrtimin e ankesave ndaj Komisionit të Karrierës Diplomatike dhe Disiplinës.

Në këtë kre është bërë një trajtim i hollësishëm i kriterëve që duhet të plotësohen për të qenë Kre i Misionit Diplomatik apo Postit Konsullor, si dhe funksionet që duhet të kryejë krerët e tyre.

Në Kreun V trajtohet personeli shërbimit të jashtëm, kërkesat shtesë që duhet të plotësojë kandidati për tu pranuar në Shërbimin e Jashtëm (krahas atyre të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil), si dhe mënyrën e pranimit të këtij personeli në shërbimin e jashtëm.

Kreu VI trajton statusin e diplomatit të karrierës si:

- punësimi i diplomatëve të karrierës jashtë Shërbimit të Jashtëm, në pozicione që mbulojnë marrëdhëniet me jashtë në institucionet kushtetuese dhe administratës shtetërore pas marrëveshjes përkatëse ndërmjet Ministrisë dhe këtyre institucioneve, si dhe në organizatat ndërkombëtare publike në të cilat Republika e Shqipërisë është anëtare apo kandidate për anëtarësim, për periudha të përkohshme. Periudha konsiderohet vijim i pandërprerë i statusit të diplomatit dhe njihet për efekt të llogaritjes së afatit kohor të nevojshëm për përfitimin e gradës diplomatike personale.
- zhvillimi i karrierës diplomatike;
- procesi i marrjes së gradave diplomatike dhe konsullore;
- procedurat e emërimit në misionet diplomatike dhe postet konsullore, mandatin e diplomatëve të emëruar jashtë vendit, rastet e pezullimit nga detyra si dhe humbjes së statusit të diplomatëve;
- trajtimin financiar si dhe trajtimin e familjarëve të personelit të misionit diplomatik dhe postit konsullor.

Kreu VII trajton përgjegjësinë disiplinore për diplomati, si dhe çdo nëpunës civil të Shërbimit të Jashtëm për shkeljet e kryera gjatë ushtrimit të funksionit dhe realizimit të detyrave të ngarkuara, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe trajton pezullimin për diplomatët e emëruar kur ndaj tyre ka filluar një procedim penal nga shteti pritës.

Kreu VIII trajton statusin e nëpunësve civilë dhe personelit teknik dhe të shërbimit, në Ministri.

Kreu IX trajton dispozita të fundit, që kanë të bëjnë me nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit, shfuqizimin e ligjit nr.23/2015, si dhe hyrjen në fuqi të ligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucioni kryesor që ngarkohet me zbatimin e këtij akti është Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe strukturat në varësi të saj. Njëkohësisht, në zbatimin e dispozitave të veçanta të këtij akti përfshihen të gjitha institucionet shtetërore qendrore dhe vendore që kryejnë veprimtari në fushën e marrëdhënieve me jashtë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projekt ligji është hartuar nga një grup i posaçëm pune i ngritur në Ministrinë e për Evropën dhe Punët Jashtme, në përbërje të të cilit ka pasur përfaqësues edhe nga Ministria e Drejtësisë, Departamenti i Administratës Publike, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe ekspertë të jashtëm. Projektligji shpallet për konsultim publik.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare shtesë në buxhetin e MEPJ për vitin 2025 që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji janë si vijon:

Efekti financiar për zërin paga për 7 koordinatorë (paga + sigurime), 19 milion leke/ vit.

Efekti financiar për funksionimin e Akademisë Diplomatike (paga dhe sigurime) 20 milion lekë/vit.

Shpenzime operative dhe investime 12 milion lekë.